



VETËRREGULLIMI OSE RREGULLIMI I MEDIAVE TË INTERNETIT NË MAQEDONI

Gusht 2017, Shkup

Përgatitja e kësaj analize u realizua me përkrahjen e Programit CIVICA Mobilitas dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Këshillit për Etikë në Mediat e Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si reflektim i këndvështrimeve të CIVICA Mobilitas dhe të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

1. HYRJE

Në periudhën ndërmjet viteve 2008-2017, hapësira e internetit dhe mediat e internetit në Maqedoni, u shndërruan në një sferë alternative publike e cila përfaqësonte një nga „vrimat“ e pakta në të cilën, shumica e zërave të heshtur, të margjinalizuar, neutral dhe kritik arritën t’ia dilnin mbanë dhe të dëgjohej. Kjo rritje e sferës së internetit është një lloj përgjigjeje ndaj mjedisit politik në të cilin qendrat politike të pushtetit dominonin me pjesën më të madhe të mediave kryesore tradicionale.

Rritja e sasisë së informacioneve dhe kanaleve për përhapjen e tyre, si dhe numri i mediave të internetit pa dyshim hapën më shumë mundësi për lirinë e të shprehurit në një periudhë kur gazetaria maqedonase po mbytej në listat ndërkombëtare të rejtingut për lirinë e mediave. Megjithatë, ky shpërthim i informacioneve dhe mediave solli edhe shumë sfida për gazetarinë profesionale – nga degradimi shqetësues i standardeve etike e deri te dilemat e shumta ligjore.

Sfida kryesore me të cilën po ballafaqohet skena mediatike në Maqedoni është se si të aplikohen parimet etike dhe profesionale, të cilat vlejnë për mediat tradicionale, edhe nga ana e mediave të internetit, të cilat po bëhen një burim gjithnjë e më i madh për informimin e publikut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse marrim parasysh kontekstin shoqëror-politik në të cilin funksionon industria mediatike në Maqedoni në dekadën e fundit, kur qendrat politike të pushtetit janë përpjekur që në mënyrë agresive ta imponojnë kontrollin e tyre edhe mbi mediat e internetit. Kjo rezultoi me përhapjen e disa fenomeneve më ekstreme në shoqëri, si gjuha e urrejtjes, diskriminimi mbi baza të ndryshme, nacionalizmi, lajme të rreme dhe propaganda, por edhe formimin e konkurrencës jo lojale të atyre subjekteve mediatike, tradicionale ose media të internetit, të cilat respektojnë rregullat profesionale dhe afariste.

Megjithatë, tendenca e zhvillimit të komunikimit në rrjetet sociale po zhvillohet paralelisht. Shumë aktorë – individë, aktivistë qytetarë, politikanë, madje edhe subjekte politike dhe institucione, kanë kuptuar fuqinë dhe potencialin e rrjeteve sociale, dhe kanë filluar t’i përdorin në mënyrë intenzive në proceset e krijimit të opinionit publik.

„Megjithëse mediat e reja i inkurajojnë njerëzit që të nxjerrin në pah atë që kanë në mendje, në demokraci nevojiten gazetarë të pavarur të cilët punojnë për të ofruar lajme dhe analiza të besueshme dhe të paanshme“, thotë Dunja Mijatović, ish-përfaqësuese e OSBE-së për lirinë e mediave.¹

Pikërisht për të siguruar informacione të besueshme dhe të pavarura në internet, e së paku zvogëlimin e abuzimeve të shpeshta dhe fenomeneve ekstreme të cilat në vazhdimësi ndotin hapësirën e internetit në Maqedoni, u hap edhe dilema: A nevojiten zgjidhje ligjore të cilat do ta rregullojnë punën e mediave të internetit? Apo, çështjet profesionale do të mund të zgjidhen në suaza të vetë profesionit përmes mekanizmave ekzistues për vetërregullim?

¹ Hulin, A. dhe Ston, M., (Ur.) *Udhërrëfyes për vetërregullimin e mediave online*, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>.

Kjo analizë do të përshkruajë postulatet ligjore dhe standardet etike që kanë të bëjnë me mediat e internetit dhe do të identifikojë disa prej problemeve me të cilat ballafaqohet gazetaria e internetit në Maqedoni; do të japë një pasqyrë të shkurtër të disa standardeve dhe rekomandimeve nga organet relevante ndërkombëtare dhe do të ofrojë shembuj të mekanizmave nga praktika ndërkombëtare për ballafaqim me problemet etike dhe profesionale të mediave të internetit.

2. INTERNETI SI NJË BURIM QË PO SHËNON RITJE NË INFORMIMIN E PUBLIKUT NË MAQEDONI

Baza e zhvillimit të shpejtë të shoqërisë informatike, e cila ka nxitur edhe përdorimin e teknologjive dixhitale në Maqedoni - nga niveli individual, në atë institucional e deri në nivelin korporativ – mundësohet falë teknologjisë me kosto të ulët, mbulimit të mirë infrastrukturor dhe qasjes së lehtë që kanë përdoruesit.

Në vitin 2016, në Maqedoni, 75% e familjeve kishin qasje në internet, dhe përfafërsisht rreth 72% përdorues të internetit të grupmoshës prej 15 deri në 74 vjet. Megjithatë, përqindja e subjekteve afariste me 10 ose më shumë të punësuar ishte e lartë dhe arrinte 94%². Pothuajse të gjitha institucionet shtetërore dhe arsimore kanë qasje në internet.

Si rezultat i këtyre faktorëve, rritet edhe numri i mediave të internetit dhe i frekuencës së komunikimit përmes internetit. Studimet tregojnë se interneti dhe mediat e internetit po bëhen një burim gjithnjë e më i madh informacioni për publikun në Maqedoni, megjithëse televizioni vazhdon të mbajë primatin. Sipas anketës së IRI³, interneti dhe faqet e internetit në vitin 2016 kanë qenë në vendin e dytë me 37% si burim i lajmeve politike për publikun, që është dy herë më shumë se në vitin 2014 (19%). Edhe hulumtimi i kryer në kuadër të projektit ndërkombëtar Infokor⁴ konfirmon një tendencë të ngjashme, sipas së cilës në vitin 2016, pas televizionit, si burim i parë i informacionit (74.5%), kanë pasuar bisedat me palë të ndryshme (të afërm, miq dhe kështu me radhë, 57%), e më pas lajme dhe komente të shkruara nga miqtë në rrjetet sociale (41%), faqe informative interneti, duke përfshirë edhe agregatorët për lajme (31.5%) dhe lajme nga lidhjet (linqet) që përdoruesit i kanë hasur në rrjetet sociale (31.3%)⁵.

Përveç kësaj, numri i profileve të *Fejsbukut* në Maqedoni arrin mbi 1 milion, gjysma e të cilëve besohet të jenë përdorues individual.⁶ Studiuesit vlerësojnë se ekzistojnë ndërmjet 200-300 agregatorë të ndryshëm për lajme që mund të arrijnë deri te mbi 10.000 lexues, „por shumica e tyre merren me argëtim, dhe ndoshta vetëm një e dhjeta (20-30, shënimi ynë) e tyre në mënyrë më serioze dhe të strukturuar merren me prodhimin e pavarur të përmbajtjeve që

² Enti Shtetëror i Statistikave i RM-së, Statistika sipas sferave – shoqëri informatike: tregues kryesorë për vitin 2016. Gjetet në: <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=27>.

³ Center for insights in survey research, „*Survey of Macedonian Public Opinion*”, April 19-25 2016, IRI. Gjetet në: http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/iri_macedonia_survey_april_2016_0.pdf. Faqe. 51.

⁴ Prezantim në konferencë për projektin *INFOCORE*, e mbajtur në Ohër, më 4 korrik 2016, në suaza të projektit „*INFOCORE-Informing Conflict Prevention, Response and Resolution: The role of Media in Violent Conflict*“.

⁵ Ibid.

⁶ Saraçini, P., (ed.) et al., *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisë gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në:

http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf. Faqe 11.

kanë të bëjnë me çështje politike, ekonomike, arsimore dhe çështje të tjera me interes publik...⁷ Sa për ilustrim, agregatori më i famshëm për lajme në Maqedoni, Time.mk, përfshin rreth 130 media në internet (këtu bëjnë pjesë edhe botimet elektronike të mediave tradicionale dhe vendase të internetit) si burime të lajmeve në gjuhën maqedonase, dhe 41 media të internetit në gjuhën shqipe.⁸

Zhvillimi i teknologjive informatike dhe të komunikimit ka pasur një ndikim të rëndësishëm mbi eko-sistemet mediatike në nivel global. Ajo nënkuptonte edhe ndryshime domethënëse në mënyrën e funksionimit të mediave tradicionale, të modeleve të tyre ekonomike dhe standardeve profesionale. Tendencat globale vërshojnë edhe sistemet e mediave lokale, kështu që skena mediatike ndryshoi dukshëm edhe në Maqedoni.

Pa marrë parasysh që ata nuk kanë aq shumë ndikim si televizioni dhe pavarësisht cilësisë së përmbajtjeve që shpërndajnë, në një situatë kur në Maqedoni u mbyllën shumë gazeta, disa media interneti me përmbajtje informative, janë duke u përpjekur që me pak a me shumë sukses, ta plotësojnë hapësirën e krijuar. Konkurrenca e krijuar nga mediat e internetit tashmë është një realitet, andaj në mënyrë të pashmangshme duhet konsideruar ato, tani ose në të ardhmen, si aktorë relevantë në skenën mediatike. Kjo nënkupton edhe një detyrim për ata që të veprojnë me përgjegjësi ndaj publikut të tyre.

3. RREGULLATIVA LIGJORE DHE MEDIAT E INTERNETIT

Në Maqedoni, mediat e internetit as janë të definuara, as të përfshira me ligjet e mediave – Ligji për media dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Megjithatë, në dhjetëra ligje të tjera të ndryshme, të cilët nuk kanë të bëjnë në mënyrë strikte me sferën mediatike, ekzistojnë disa dispozita që rregullojnë në mënyrë indirekte punën dhe sjelljen e mediave të internetit, krijimin e përmbajtjeve dhe shpërndarjen e tyre për publikun në internet.

Rregullativa ligjore e cila rregullon sferën mediatike⁹ në Maqedoni nuk përmban dispozita eksplicite që kanë të bëjnë me mediat e internetit të cilat janë krijuar dhe ekzistojnë ekskluzivisht në internet. Subjekt i Ligjit për media (2013) janë botuesit e mediave, e në të mediat përkufizohen si “mjete për informim publik, respektivisht çdo lloj komunikimi si gazetat, revistat, programe radio dhe televizione, teleteksti dhe mjete të tjera për botim ditor apo periodik të përmbajtjeve editoriale në formë të shkruar, audio ose fotografi, me qëllim që të informohen dhe plotësojnë nevojat kulturore, edukative e të tjera, të publikut më të gjërë” (Neni 2).¹⁰ As Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (2013) nuk i përfshin mediat e internetit, duke theksuar se i njëjti nuk mbulon kërkuesit ose versionet elektronike të gazetave dhe revistave (Neni 3, paragrafi 1).

⁷ Ibid. Faqe 12

⁸ Ueb-faqeja e agregatorit të internetit për lajme Time.mk. Gjetet në: <http://www.time.mk/s/all>.

⁹ Ligji për media (2013) dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (2013). Gjetet në: www.avmu.mk.

¹⁰ Ligji për media (2013), Neni 2. Gjetet në: www.avmu.mk.

Pikërisht për shkak se mediat vendase të internetit nuk janë të përfshira me rregullativën mediatike, ishin kontradiktore ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor (2016)¹¹ para zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2016, të cilat në pjesën që i referohej paraqitjes mediatike në fushatën zgjedhore (Neni 75), përveç mediave tradicionale, përfshinin edhe mediat elektronike, respektivisht portalet e internetit. Me këto ndryshime, Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale iu imponua detyrimi ligjor për ta përcjellur paraqitjen zgjedhore mediatike dhe shërbimin programor të radiodifuzerëve dhe të mediave elektronike (portalet e internetit) në Maqedoni, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e votimit (Neni 76-c); të fillojë procedurë kundërvajtëse kundër tyre nëse nuk veprojnë në përputhshmëri me Kodin zgjedhor (Neni 76-c, paragrafi 3), dhe janë paraparë edhe dënime për mediat elektronike (portalet e internetit) nëse nuk raportojnë mbi zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, nuk ju sigurojnë kushte të barabarta për qasje të gjithë pjesëmarrësve në fushatë, nëse financojnë apo japin mjete për partitë politike, etj (Neni 181-a). Agjencia duhej të miratojë një Metodologji për monitorimin e prezantimit elektoral mediatik përmes shërbimeve të programeve radio-televizive dhe mediave elektronike (portaleve të internetit) gjatë proceseve zgjedhore (Neni 76-c, paragrafi 8). Megjithatë, trupi rregullator vendosi të mos monitorojë portalet e internetit në fushatën zgjedhore, me arsyetimin se "Kodi nuk përkufizon termin 'portalet e internetit' ose fushëveprimin e tij", dhe një përkufizim i tillë nuk ekziston as në ligjet e tjera.¹² Sipas Agjencisë, nuk ekziston një regjistër i portaleve të internetit dhe disa nga personat juridik që duhet të përfshihen në këtë kategori në Regjistrin Qendror, janë regjistruar nën një veprimtari tjetër, siç janë shoqatat e qytetarëve ose agjencitë e lajmeve. Rregullatori argumentoi se në praktikën rregullatore evropiane nuk ka shembuj për monitorimin e përmbajtjeve të mediave të internetit nga ana e trupave rregullatorë.¹³

Megjithatë, mediat e internetit nuk përjashtohen nga rregullative ligjore, sidomos kur bëhet fjalë nga aspekti i përmbajtjes që krijojnë dhe shpërndajnë për publikun. Analiza "*Maqedonia në epokën dixhitale - midis të drejtave dhe përgjegjësisve gjatë komunikimit në internet*" ofron një pasqyrë të legjislacionit që mbulon mediat e internetit.¹⁴ Dispozitat që kanë të bëjnë me disa çështje të ndjeshme, siç janë *gjuha e urrejtjes, shpifja dhe fyerja, e drejta e autorit, e drejta për privatësi, mbrojtja e të miturve, etj*, janë po aq të vlefshme dhe të zbatueshme si për mediat tradicionale ashtu edhe për mediat që veprojnë në internet, e që në esencë janë standarde evropiane.

Kështu, *Kodi penal* (1996) sanksionon nxitjen e ndryshimit të dhunshëm të rendit kushtetues (Neni 318), gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin (Neni 319 dhe Neni 417), parasheh dënim kundër personit i cili me ndihmën e sistemit informativ do të mohojë publikisht, do të minimizojë në mënyrë brutale, do të miratojë a justifikojë gjenocidin, krimet kundër njerëzimit

¹¹ Kodi zgjedhor (2016), (tekst i spastruar). Gjetet në: <https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zM2lkMkZERFoONXc/view>.

¹² ASHMAAV, „Qëndrimi i Agjencisë lidhur me obligimin për të kryer monitorim mbi prezantimin elektoral mediatik në portalet e internetit“, ASHMAAV, Shkup, 2016. Gjetet në: http://avmu.mk/images/Stav_na_Agencijata.pdf.

¹³ Ibid.

¹⁴ Saraçini, P., (ed.) et al., *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisve gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në: http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf.

apo krimet e luftës (Neni 407-a) dhe ndalon përhapjen e materialeve raciste dhe ksenofobike përmes një sistemi kompjuterik (Neni 394-ç).¹⁵

Ndërkohë, *Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje (2012)*,¹⁶ përfshin edhe mediat e internetit në mesin e mjeteve për informim publik (përmbajtje programore editoriale për publikun e gjërë) përmes të cilave mund të bëhet fyerja a shpifja (Neni 6 dhe Neni 8). Për to vazhdon poashtu edhe e drejta e reagimit, demantit dhe korigjimit, si dhe dëmshpërblimet për dëme (Neni 13-16).

Ligji i rëndësishëm së veçantë për kontekstin maqedonas të internetit është *Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesve*, sipas të cilit edhe personat juridik, siç janë në këtë rast portalet e internetit, mund të konsiderohen si vepra të autorit. Prandaj, ata janë të obliguar sa herë që shkarkojnë çfarëdo materiali nga burime të tjera, ta shënojnë autorin nga i cili marrin përmbajtjet.¹⁷

Këtu bën pjesë edhe *Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*, sipas të cilit vepron Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe e cila deri më tani, me kërkesë të qytetarëve ka reaguar atëherë kur janë publikuar fotografi pa pëlqimin e individëve, publikimin e të dhënave të huaja personale, vjedhjen e identitetit, abuzimin e fjalëkalimit dhe krijimin e profileve të rrejshme në internet.¹⁸ Sipas këtij ligji, ndalohet publikimi i fotografive në portalet e internetit pa pëlqimin paraprak të individëve, shkarkimin e fotografive nga *Fejsbuku* dhe publikimin e tyre në portalet e internetit, e nëse publikohen fotografi të të miturve, nevojitet pëlqimi i prindërve. Drejtoria ka kompetenca të fshijë profilet e rremë në rrjetet sociale. Ajo reagon ndaj ankesave të qytetarëve, pjesa dërmuese e të cilave kanë të bëjnë me keqpërdorimin e të dhënave personale në rrjetet sociale dhe në portalet e internetit.¹⁹

Rreth dhjetëra ligjesh, duke përfshirë edhe *Ligjin për qasjen e lirë në informata me karakter publik*, *Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi*, *Ligjin për marrëdhëniet e punës* dhe *Ligjin mbi materialin arkivor*, tregojnë se sfera e mediave të internetit nuk është e parregulluar siç duket në shikim të parë. Përkundrazi, shumë dispozita të shpërndara nëpër të gjitha ligjet e numëruara rregullojnë aspekte të ndryshme të veprimit, krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve nga mediat e internetit.

Puna joprofesionale dhe joetike e mediave të internetit është pjesërisht e lejuar nga moszbatimi i këtyre ligjeve ekzistuese në praktikë, dhe poashtu, për shkak të inercionit të institucioneve kompetente gjatë veprimit, si dhe në sanksionimin e disa fenomeneve të caktuara siç është, për shembull, gjuha e urrejtjes. Studimet e ligjeve që përfshijnë edhe mediat e internetit sugjerojnë gjithashtu se "Maqedonia ka legjislacion mjaft të mirë, i cili është i

¹⁵ Kodi penal I Republikës së Maqedonisë (1996). Gjetet në:

<http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20precisten%20%20tekst.pdf>.

¹⁶ Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje (2012). Gjetet në: <http://bit.ly/2vS37SY>.

¹⁷ Saraçini, P., (ed.) et al., *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësive gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në:

http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf. Faqe 27.

¹⁸ Ibid. Faqe 24.

¹⁹ Ibid.

aplikueshëm në sferën e internetit dhe nuk ka nevojë për rregullim shtesë të komunikimit në Internet."²⁰

Prandaj, para se të hapet debati mbi nevojën për ndonjë rregullim shtesë të mediave të internetit, rekomandimet janë që fillimisht nevojitet zbatim joselektiv, i drejtë dhe proporcional i ligjeve ekzistuese për të gjithë aktorët në komunikim me publikun,²¹ në mënyrë që të mbrohen të drejtat dhe dinjteti i njeriut, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për media të internetit ose media tradicionale.

4. STANDARDET ETIKE DHE MEDIAT E INTERNETIT – CILAT JANË SFIDAT NË PRAKTIKË?

Sasia e informacioneve që janë në dispozicion në internet, nga njëra anë rritin informimin dhe njohuritë, por nga ana tjetër, verifikimi i saktësisë dhe besueshmërisë së atij informacioni u tregua si një sfidë e madhe. Ambienti dixhital solli aso risish dhe sfidash për gazetarinë profesionale dhe për biznesin mediatik, për të cilat debati në industrinë mediatike në korniza më të gjera ndërkombëtare, madje edhe në Maqedoni, ende po vazhdon. Problemi është global dhe përmban shumë aspekte, por kjo analizë do të përqendrohet në përmbajtjen e prodhuar nga mediat e internetit në Maqedoni, a i respektojnë standardet profesionale dhe cilat mekanizma vetë-rregullues i ka ky komunitet në dispozicion nëse shkelen parimet etike.

Profesionistë të kësaj fushe, e sidomos përfaqësues të mediave të internetit, të cilët deklarohenë se punojnë sipas standardeve etike dhe profesionale, theksonin shkëlqen e standardeve profesionale dhe konkurrencën e pandershme që krijojnë media të caktuara të internetit, të cilët kishin sukses në tërheqjen e reklamave si nga klientët komercial ashtu edhe nga reklamimi shtetëror,²² si dhe për të mbijetuar në treg. Edhe Asociacioni maqedonas i mediave, i cili bashkon pesë televizionet komerciale tokësore në nivel kombëtar, para zgjedhjeve parlamentare në vitin 2016 argumentoi se transmetuesit janë të diskriminuar në raport me portalet e internetit, për të cilat konkludon se "mund të publikojnë çfarë të duan dhe kur të duan, pa patur mundësinë që t'u shqiptohet ndonjë sanksion."²³

Argumentet për këto reagime mund të gjenden në praktikën e përditshme: media të shumta në internet veprojnë pa impresum dhe pa të dhëna mbi strukturën e pronësisë. Në disa raste, në impresum janë shënuar një deri dy persona, për të cilët nuk dihet nëse janë redaktorë apo gazetarë, e në raste të tjera qëndron vetëm "personi për kontakt". Redaksitë e mediave vendase të internetit, të cilat prodhojnë përmbajtje informative janë të vogla, të përbëra prej disa gazetarëve dhe redaktorëve të cilët punojnë në kushte modeste (ndonjëherë edhe nga shtëpia) dhe marrin paga modeste. Studimet tregojnë se "redaksitë me staf adekuat janë shumë të rralla."²⁴ Gazetarët në mediat e internetit zakonisht angazhohen me honorarë, "ata

²⁰ Ibid. Faqe 44.

²¹ Ibid.

²² Qeveria shpalli moratorium të financimit shtetëror në mes të vitit 2015.

²³ Oda ekonomike e Maqedonisë - AMM, „Kërkesë nga AMM“, 31 gusht 2016. Gjetet në: http://avmu.mk/images/Baranje_od_MMA.pdf.

²⁴ Saraçini, P., (ed.) et al., *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisë gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në: http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf. Fq. 12.

i kanë të njëjtat detyra si të punësuarit e rregullt, por jo edhe të drejtat e njëjta.²⁵ Si rezultat, përmbajtjet që shumë media të internetit i prodhojnë janë me cilësi të dobët dhe shpesh vërehen shkelje të standardeve etike dhe profesionale, senzacionalizëm dhe tabloidizim.

Megjithatë, abuzimi i të drejtave të autorit paraqet një nga problemet më të mëdha, i cili manifestohet përmes marrjes së teksteve dhe imazheve nga mediat e tjera tradicionale ose të internetit, me ç'rast nuk atribuohet autori ose burimi i vërtetë i informacionit. Gjithashtu edhe mediat e internetit dhe rrjetet sociale kanë krijuar hapësirë për përhapjen e *gjuhës së urrejtjes, fjalimit nxitës, nacionalizmit dhe diskriminimit*. Megjithatë, përhapja e lajmeve të rreme nëpër faqet e internetit dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, siç ishte rasti me të rinjtë nga Velesi që krijuan ueb-faqe të rreme, është shembulli më i spikatur i rrënimit të parimeve gazetareske dhe besimit të publikut në media, pavarësisht nga platforma mbi të cilën ata funksionojnë.²⁶ Një dukuri tjetër ishin edhe mediat e internetit të kontrolluara nga qendrat politike të pushtetit, të cilat publikonin lajme të ngjashme ose identike në mbështetje të ideologjisë politike apo nxirjes së opsioneve të kundërta, të cilat janë cituar shpesh edhe nga televizionet më të shikuara kombëtare.²⁷

Në mungesë të investigimeve të hollesishme të profileve dhe përmbajtjes së mediave të internetit, mbështetje indikative për këto fenomene mund të gjendet edhe në analizën e organit vetërregullues - Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni,²⁸ i cili në bazë të vendimeve të Komisionit për Ankesa konstaton se shumë media të internetit kanë shkelur parimet e vërtetësisë dhe saktësisë në përcjelljen e informacionit, apo se u mungon "ana tjetër" në tekstet që janë shqyrtuar. Në mediat online kanë dominuar përmbajtjet mediatike që mund të kategorizohen si komente, e nuk bazohen në ndonjë *lajm dhe fakte*. Në shumë portale, sikur edhe te stacionet televizive, janë vërejtur *tekste propagandistike dhe të njëanshme* në shërbim të pushtetit. Komisioni konstatoi se gjuha e urrejtjes më së shpeshi është përdorur në mediat online dhe nga ana e disa autorëve të emisioneve, si dhe në komentet e lexuesve të mediave online.²⁹

Është e pashmangshme të theksohet se në këtë valë të mediave dhe informacionit në hapësirën e internetit në Maqedoni, ka edhe të tillë që respektojnë standardet etike dhe profesionale, kanë një strukturë transparente editoriale dhe pronësore dhe përpiqen të punojnë në mënyrë konkurruese në tregun mediatik. Këshilli për etikë në media në Maqedoni ka 16 anëtare, media të internetit, të cilët janë zotuar që të respektojnë Kodin e Etikës të Gazetarëve, Statutin e KEMM-it dhe vendimet e Komisionit për Ankesa.

²⁵ Tuneva, M. and Milenkovski, S., *Employment and Working Conditions for the Journalists in the Republic of Macedonia*, MIM, Skopje, 2015. Gjendet në: http://seemediapartnership.cji.ro/wp-content/uploads/2017/02/Macedonia_Final.pdf. Стр. 10.

²⁶ Jenkins, C., "Fake online news from Macedonia: who's behind it?", Channel 4, 24 nëntor 2016. Gjendet në: <https://www.channel4.com/news/fake-news-in-macedonia-who-is-writing-the-stories>.

²⁷ Në periudhën parazgjedhore, para zgjedhjeve parlamentare në dhjetor të vitit 2016, disa televizione proqeveritare emitonin TV emisione me përmbajtje demonizuese të publikuara në portale dhe gazeta proqeveritare. Shiko më shumë në Raportin mbi monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në lajmet televizive, 30 nëntor - 9 dhjetor 2016, Projekti „MODEM“, ISK, 2016. Gjendet në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM/dek/MODEM-izvestaj-dekemvri-MK.pdf>. Fq. 54.

²⁸ Tahiri, S. Dhe Adamçevski, M., Raportimi në interes të publikut – Mbrojtja e parimeve etike të raportimit gjatë punës së Komisionit për ankesa, KEMM, Shkup, 2017. Gjendet në: <http://www.semm.mk/attachments/izvestuvanje-vo-interes-na-javnosta.pdf>.

²⁹ Ibid.

Megjithatë, shumica e komunitetit mediatik, kundërshtoi çdo rregullim të mediave të internetit që nga fillimi i miratimit të ligjeve të mediave, madje edhe të ashtuquajturin "rregullim të butë", që nënkupton se duhet të ketë një regjistër për ta, sikur edhe për mediat e shtypura, i cili zakonisht menaxhohet nga një institucion, siç është organi rregullator ose ministria kompetente. Arsyet qëndronin në frikën e keqpërdorimit të mundshëm të dispozitave ligjore nga institucionet, të cilat edhe më shumë do të mund ta shtypin lirinë e shprehjes, demokracinë dhe pluralizmin mediatik.³⁰

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, në vitin 2017 konfirmoi qëndrimin e saj dhe në mënyrë decide u prononcua kundër rregullimit ligjor të portaleve të internetit dhe përmabjtjeve mediatike sepse, sipas kryetarit të SHGM-së Naser Selmani: „...Sa më shumë ligje, aq më pak liri për media... SHGM-ja refuzon idenë për rregullimin e përmabjtjeve mediatike dhe secili gazetar profesionist duhet të refuzojë që shteti ta vlerësojë punën e tij si gazetar. Etika gazetareske zgjidhet përmes mekanizmave vetërregullues.“³¹

Debati mbi nevojën për rregullimin ose vetë-rregullimin e mediave të internetit në komunitetin mediatik në Maqedoni, ka gjenezën që nga miratimi i rregullativës mediatike në vitin 2013. Pastaj, pas miratimit të Ligjit për Media, organizatat mediatike arritën të largojnë "botimet elektronike" nga fushëveprimi i tij, ku përfshiheshin versionet elektronike të gazetave dhe revistave. Ky ishte hapi i vetëm i qëlluar në një moment të tillë politik, sepse rregullimi, edhe atëherë edhe tani bart shumë rreziqe, si për shoqërinë tonë ashtu edhe për shoqëritë më të zhvilluara dhe më demokratike.

5. RREGULLIMI DHE VETË-RREGULLIMI I MEDIAVE TË INTERNETIT NË PRAKTIKËN NDËRKOMBËTARE

Realiteti i ri mediatik-teknologjik ka zgjeruar fushën e të drejtave të njeriut, të cilat tani janë të vlefshme qoftë online apo offline, siç përcakton Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë të detyruar që të respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut edhe në internet. Prandaj, çdo përpjekje për të krijuar ndonjë qeverisje me internetin në nivel kombëtar, rajonal apo global duhet të bazohet në kuptimin e konceptit të lirisë së internetit.

Shtetet kanë obligim që të krijojnë një ambient të favorshëm për lirinë në internet. Prandaj, Rekomandimet e Këshillit të Evropës (CM/Rec(2016)5)³² theksojnë se ligjet dhe politikat që kanë të bëjnë me internetin duhet të përgatiten nga autoritetet shtetërore në një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, i cili do të përfshijë të gjithë palët e interesit siç janë: sektori privat, shoqëria civile, komuniteti akademik dhe teknik.

³⁰ Blazhevska, K., „Po' për lirinë, jo' për ligjin“, Deutsche Welle, 29 prill 2013. Gjetet në: <http://b2.mk/news/da-za-slobodata-ne-za-zakonot?newsid=FCEN>.

³¹ „SHGM dhe EFJ kundër rregullimit ligjor të portaleve dhe përmabjtjeve mediatike“, Nova Makedonija, 26 prill 2017. Gjetet në: <http://bit.ly/2hO4Cvv>.

³² Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC (2016)5*, Komiteti i ministrave, 13 prill 2016. Gjetet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415fa.

Sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me lirinë e medias, pavarësia editoriale e mediave që veprojnë në internet, duhet të garantohet në ligje dhe në praktikë. Mediat nuk duhet të marrin një licencë të veçantë, përveç regjistrimit të thjeshtë për të bërë biznes, në mënyrë që ata të mund të punojnë në internet ose në një blog. Hetimet lidhur me kërcënimet dhe krimet ndaj gazetarëve dhe aktorëve të rinj të medias duhet të jenë të shpejta dhe efektive, ndërsa praktika e mosndëshkimit duhet të shmanget.³³ Këshilli i Evropës thekson se gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave që përdorin internetin, nuk duhet t'u nënshtrohen kërcënimeve apo ngacmimeve dhe nuk duhet të praktikojnë vetëcensurim, si frikë nga ndëshkimi, ngacmimet apo sulmet.

Si rezultat i ndryshimit të ekosistemeve të mediave, Këshilli i Evropës u rekomandon shteteve anëtare të miratojnë përkufizime të reja, më të gjera, të mediave që do të mbulojnë të gjithë aktorët e përfshirë në prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve, me ç'rast do të kishin kontroll editorial; t'i rishqyrtojnë kërkesat rregullative duke marrë parasysh të gjithë aktorët që ofrojnë shërbime apo produkte në eko-sistemet mediatike; të angazhohen në dialog me të gjithë aktorët në sistemin mediatik; të miratojnë strategjitë për promovim dhe zhvillim, ose të sigurojnë ofrimin e duhur të servisit publik, për të siguruar një nivel të kënaqshëm të pluralizmit, diversitetit të përmbajtjes dhe kështu me radhë.³⁴

Krijuesit e politikave të mediave duhet marrë parasysh gjashtë kritere për të vërtetuar nëse aktivitete, shërbime apo aktorë të caktuar duhet të konsiderohen si media në eko-sistemet e reja: qëllimin për të vepruar si një media, objektivat bazë të mediave, kontrolli editorial, standardet profesionale, përfshirja dhe shpërndarja dhe pritjet nga ana e publikut.³⁵ Standardet profesionale vlejné edhe për mediat e reja, të cilat mund ta bëjnë atë nëpërmjet deklaratave në lidhje me misionin e tyre, rregullat për punonjësit, ose kushtet për përdorimin e medias. Edhe kriteri - pritjet e publikut - përmban treguesit: respektim i standardeve profesionale dhe etike, llogaridhënien, transparencën dhe besueshmërinë, të cilat mediat duhet t'i përmbushin në sistemin e ri mediatik.³⁶

Edhe OSBE-ja mbështet qëndrimin se mediat e internetit që pretendojnë të merren me gazetari, duhet të respektojnë të njëjtat standarde etike dhe profesionale që vlejné për mediat tradicionale. "Standardet etike duhet të aplikohen nga të gjithë që punojnë në fushën e lajmeve dhe informimit publik, nëpër të gjitha platformat e mediave", thotë Ejden Uajt (Aiden White), duke shtuar se sfidat etike të gazetarisë, siç janë - e vërteta, mos të bëhet dëm, përgjegjësia dhe pavarësia - mbeten të njëjta si më parë.³⁷ Sipas tij, ndryshimi i shpejtë i ambientit mediatik imponon nevojën për plotësim me udhëzime të reja mbi parimet e vendosura tashmë që vlejné për mediat jo-digjitale.³⁸

³³ Ibid.

³⁴ Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC(2011)7*, Komiteti i ministrave, 21 shtator 2011. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/101403?download=true>.

³⁵ Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC(2011)7*, Komiteti i ministrave, 21 shtator 2011. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/101403?download=true>.

³⁶ Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC(2011)7*, Komiteti i ministrave, 21 shtator 2011. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/101403?download=true>.

³⁷ Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>. Fq. 67.

³⁸ Ibid.

Për shkak të numrit të madh të informatave, përmbajtjeve dhe përdoruesve të internetit, gazetaria po bëhet gjithnjë e më komplekse dhe më demokratike dhe "ky peizazh i ri demokratik kërkon shumë më tepër vetë-rregullim, që konsiderohet si mënyra më e mirë për të ndjekur standardet etike mediatike" thotë Uajt.³⁹ Cilësia dhe përgjegjësia e mediave të internetit mund të rriten vetëm përmes edukimit. Mediat duhet të inkurajohen që të vendosin dhe zbatojnë parimet dhe standardet në punë, nëse dëshirojnë të merren me gazetari, rekomandon ai.

Përparësitë e vetë-rregullimit janë në atë se përfaqëson një mekanizëm për mbrojtje kundër ndërhyrjeve të mundshme të qendrave të pushtetit në përmbajtjet mediatike, si në ato tradicionale, ashtu edhe në mediat që veprojnë në internet. Në vend të rregullimit të tepërt dhe mundësisë së kufizimeve të reja rregullatore mbi mediat e internetit dhe lirinë e shprehjes, vetë-rregullimi ofron një alternativë për gjykatat gjatë zgjidhjes së ankesave për përmbajtjet mediatike. Kjo, sigurisht, nuk përjashton të drejtën e publikut, domethënë qytetarit, të fillojë procedura para gjykatës.

Vetë-rregullimi është më efikas se rregullimi i mediave të internetit për disa arsye: në kushte të ndryshimeve të vazhdueshme në teknologjinë mediatike, ajo ofron një fleksibilitet më të madh në krahasim me rregullimin nga ana e shtetit; është më efikas dhe zgjat më pak se procesi i gjatë dhe i ndërlikuar gjyqësor, dhe më në fund - vetë-rregullimi ka kosto më të ulët për qeveritë dhe shoqërinë.⁴⁰ Dobësia e tij është se nuk mund të detyrojë askënd për asgjë, sepse ai shqipton vetëm sanksione morale. Autoritetet kompetente, megjithatë, mund të mos u përgjigjen ofendimeve të caktuara online, duke marrë parasysh se ndërmjetësit në internet do ta largojnë përmbajtjen. Mediat e internetit mund të heqin përmbajtjen problematike nga një ueb-faqe, por ajo mund të paraqitet më vonë diku tjetër.

Sipas NENIT 19, kur zgjedhim midis rregullores dhe vetë-rregullimit, duhet t'i kushtohet vëmendje kriterit të domosdoshmërisë: a është vetë-rregullimi efektiv për të arritur qëllimin e interesit publik apo është rregullim i domosdoshëm për arritjen e këtij qëllimi? Kur duhet promovuar dhe realizuar disa qëllime të një interesi legjitim publik, vetë-rregullimi është zgjedhja e parë për ta sepse është më pak kufizues sa i përket lirisë së shprehjes. Të dy mekanizmat - si vetë-rregullimi ashtu edhe rregullimi, sipas NENIT 19, duhet të jenë efektiv dhe të kenë fuqinë për t'i bërë aktorët të përgjegjshëm, dhe nga ana tjetër të jenë në gjendje për ta mbrojtur publikun.⁴¹

Në Komisionin Evropian po zhvillohet debat mbi rishikimin e mundshëm të Direktivës për shërbime mediatike audiovizuale, ku ekzistojnë propozime që të gjitha shërbimet mediatike audiovizuale të vendosen nën kompetencat e autoriteteve rregullatore. Propozimi ka të bëjë me të gjithë shërbimet mediatike, persona juridik apo fizik, të cilët kanë përgjegjësi editoriale. NENI 19 shfaq shqetësimin se kjo mund të çojë drejt rregullimin të panevojshëm të mediave

³⁹ Ibid. Fq. 70.

⁴⁰ Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>. Fq. 84.

⁴¹ ARTICLE 19, 2016 Annual Colloquium on fundamental rights—Public consultation on "MEDIA PLURALISM AND DEMOCRACY", Response of ARTICLE 19, 2016. Gjetet në: http://ec.europa.eu/information_society/newsroom/image/document/2016-44/article_19_en_18798.pdf. Fq. 1.

vendase të internetit dhe shohin arsyetim në këtë masë vetëm nëse bëhet fjalë për servise që kanë *ndikim të dukshëm mbi një pjesë të konsiderueshme të publikut*, me çka nënkuptohet pjesën e tregut të kompanisë, pjesëmarrjen e publikut, numrin e shikimeve online të servisit në një periudhë të caktuar, kompani fitimprurëse apo jofitimprurëse, madhësinë e kompanisë apo reputacionin e saj në mesin e publikut. Duke marrë parasysh faktin se shërbimet mediatike mund të shpërndahen nëpërmjet kanaleve të ndryshme, NENI 19 rekomandon që BE-ja ta marrë parasysh ndikimin global në një pjesë të konsiderueshme të publikut, përes kombinimit të kanaleve të ndryshme, gjë që është tipar i mas mediave.

Sipas NENIT 19, kjo duhet të jetë një „prag“ nga i cili duhet të udhëhiqet debati rreth asaj se a ka nevojë dhe cilat shërbime mediatike audiovizuale do të bien nën kompetencat e autoriteteve rregullatore.⁴²

6. SHEMBUJ PËR TRAJTIMIN E MEDIAVE TË INTERNETIT TË CILAT SHKELIN STANDARDET ETIKE DHE PROFESIONALE

Me shpërthimin e mediave të internetit dhe të sasisë së përmbajtjeve që mund të gjenden online, u paraqit nevoja për ridefinimin e vetë-rregullimit mediatik në drejtim të përshtatjes së metodave të punës së organeve vetë-rregulluese ndaj mjedisit të ri dixhital. Një studim⁴³ tregon se në vitin 2015, prej 99 kodeve etike të hulumtuara të vendeve të ndryshme të botës, vetëm nëntë prej tyre kishin përshtatur dhe përfshirë internetin dhe teknologjitë e informatikës dhe komunikimit. Më së shumti referenca për mediat e reja janë gjetur në kodet e etikës të Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Norvegjisë.

Vetë-rregullimi mund të përfshijë forma dhe modalitete të ndryshme – ai mund të jetë një proces i brendshëm i vetë kompanisë (kodi etik, ombudsmani ose "kiberombudsmani" i cili është përgjegjës për mediat dhe komunikimin në internet), vetë-rregullim në nivel të një segmenti të industrisë (vetëm në shtyp ose vetëm në industrinë e internetit),⁴⁴ ose vetë-rregullim që mbulon të gjitha llojet e mediave.

Këshilli për etikë në media në Maqedoni (KEMM) është formuar sipas modelit të fundit, i cili përveç mediave tradicionale, i përfshin edhe mediat online. KEMM-i, respektivisht trupi i ashtuquajtur Komisioni për ankesa, i shqyrton parashtresat lidhur me shkeljen e standardeve profesionale dhe etike në mediat e shkruara (shtypi dhe agjencitë e lajmeve), elektronike (TV dhe radio) dhe në mediat e internetit në Maqedoni. Trupi vetë-rregullues në Maqedoni, veprimtarinë e tij e bazon në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë, i miratur në vitin 2001, në Parimet e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, si dhe në Kartën për raportim etik gjatë zgjedhjeve. Kjo do të thotë se edhe mediat e internetit të cilat janë anëtare të KEMM-it, janë të obliguara që t'i respektojnë të gjitha parimet profesionale dhe etike të cilat vlejné edhe për

⁴² Ibid. fq. 3.

⁴³ Diaz-Campo, J., и Segado-Boj, F., *“Journalism ethics in a digital environment: How journalistic codes of ethics have been adapted to the Internet and ICTs in countries around the world”*, Telematics and Informatics, 32 (4), 735-744, 2015. Gjetet në: <http://reunir.unir.net/bitstream/handle/123456789/2826/D%C3%8DAZ-CAMPO%20Y%20SEGADO%20-%20JOURNALISM%20ETHICS%20DIGITAL.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.

⁴⁴ Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>. Fq. 54.

mediat tradicionale. KEMM-i punon në përgatitjen e parimeve për raportim etik në internet, të cilat do t'i marrin parasysh specifikat e mediave të internetit, e të cilat do ta plotësonin Kodin aktual etik.

Në disa vende, mediat e internetit krijojnë shoqatat e tyre. I tillë është rasti në Qipro, ku 16 "mejnstrim" media online, përfshirë këtu edhe versionet e internetit të gazetave, u bashkuan në një shoqatë që pranoi Kodin e Etikës dhe u vendos nën "jurisdiksionin" e Komisionit për ankesa të mediave të Qipros. Qiproja ka edhe media të tjera online që nuk i janë bashkuar shoqatës, por disa prej tyre u përgjigjen kërkesave për bashkëpunim nëse ka ankesa kundër tyre, ndërsa ka edhe prej atyre që injorojnë plotësisht Komisionin.⁴⁵

Sot, vetë-rregullimi është një mundësi që nuk është vetëm e disponueshme, por edhe rekomandohet edhe për mediat e internetit. Anëtarësimi i mediave të internetit në organet vetërregulluese u jep atyre besueshmëri më të madhe, i ndihmon ata të "promovojnë" profesionalizmin e tyre, respektivisht të tregojnë përgjegjësi dhe garanci për sigurimin e informatave të besueshme për publikun në internet. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë se si mekanizmat vetë-rregullues mund të ndihmojnë në promovimin e praktikave profesionale të mediave të internetit ose çfarë hapash kreativ mund të ndërmerren nga aktorët në skenën mediatike për t'u marrë me fenomenet e padëshiruara në internet.

Këshilli i Mediave të Bosnjë dhe Hercegovinës, i themeluar në vitin 2000, në mesin e të parëve në kontekstin më të gjerë evropian, e ka përshtatur punën e tij ndaj epokës së re dixhitale.⁴⁶ Që nga viti 2010, ueb-portaleve të lajmeve u është lejuar të anëtarësohen në trupin vetërregullues, ndërsa kodi i tij është rishikuar në Kodin e mediave të shtypura dhe online. Këshilli ka kritere që mediat e internetit duhet t'i përmbushin për t'u bërë anëtar: lista e redaktorëve me të dhëna për kontakt, kryedredaktor, të paktën dy gazetarë profesional, pranimi i kodit dhe parimeve të vetë-rregullimit, dhe të jenë të regjistruar si SH.P.K., e jo si shoqatë apo OJQ. Këshilli është mjaft i respektuar në komunitetin mediatik dhe interesi i shumë mediave të internetit për t'u anëtarësuar është i madh, megjithëse mundësitë janë të kufizuara për shkak të kriterëve të larta. Ky trup është shumë aktiv në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të mediave të internetit. Për shembull, për të parandaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes në ueb-portale përmes përmbajtjeve të krijuara nga përdoruesit, Këshilli hapi fushatën "Nuk je i padukshëm" si një platformë e përbashkët e këtij trupi, e gjyqësorit dhe e policisë, në bashkëpunim me redaktorët e ueb-portaleve. Ky aktivitet ndodhi pas vitit 2012, pas shumë ankesave të qytetarëve rreth gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve ndaj individëve të caktuar në tekstet editoriale dhe në komentet e disa ueb-portaleve, u ngritën disa kallëzime penale kundër individëve të identifikuar.⁴⁷

Kodi Etik i Luksemburgut, sipas të cilit vepron Këshilli i atjeshëm i Etikës, thekson në mënyrë eksplicite se ai trajton edhe informacionet që shpërndahen përmes profesionistëve mediatik në internet ose në një kanal tjetër elektronik, por, detyron gazetarët që gjatë krijimit të

⁴⁵ Korrespondencë përmes e-postës me Petros Petrides, sekretar i Komisionit për ankesa nga mediat e Qipros, 8 gusht 2017.

⁴⁶ Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>. Fq. 112.

⁴⁷ Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online, OSBE, Vjenë 2013. Gjetet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>. Fq. 112.

përmbajtjeve apo krijimit të hiperlidhjeve (hyperlinks), paraprakisht të kontrollojnë ueb-faqet dhe të jenë të sigurt se nuk përmbajnë materiale të palejuara, të cilat nuk guxojnë t'i transmetojnë.⁴⁸

Për të ilustruar disa qasje efektive inovative që mund të përshtaten dhe zbatohen edhe në vendet e tjera, kemi shembullin me Qendrën e denoncimit "Syri Online" në Slloveni - një faqe interneti për denoncimin e gjuhës së urrejtjes dhe abuzimit të fëmijëve në internet (www.spletno-oko.si), e cila funksionon me sukses për 10 vjet. "Syri Online" vepron në kuadër të Qendrës për internet më të sigurt, të cilën e koordinon Fakulteti i Shkencave Shoqërore në Universitetin e Lubjanës. Anëtarë të Qendrës për internet më të sigurt janë Prokuroria e Lartë Publike e Sllovenisë dhe policia, përfaqësues të mediave dhe organizata të tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Denoncimet që vijnë në lidhje me gjuhën e urrejtjes ose abuzimin e fëmijëve në internet, analizohen dhe procedohen shpejt dhe në mënyrë efektive në polici.

Situata me aplikimin e vetë-rregullimit është më komplekse kur bëhet fjalë për rrjetet sociale, si Facebook ose Twitter, ku, sipas shumicës qëndron problem kyç i cili vështirë zgjidhet. Në vitet e fundit, Facebook dhe Twitter janë përpjekur të përballen me përgjegjësinë dhe të merren me informacione të dëmshme dhe të pasakta, duke futur një sistem për moderim dhe raportim të problemeve.

„Si këshilla për etikë, dëgjojmë tregime nga qytetarët që ndihen të pafuqishëm para disa çështjeve në rrjetet sociale. Për një qytetar është shumë e vështirë, në mos e pamundur, për të kontaktuar me Facebook ose Twitter dhe t'u drejtojë një çështje të caktuar, "tha Peter Finney, Ombudsmani për shtyp i Irlandës. Ai vë në dukje se do të ishte shumë e komplikuar që rrjetet sociale të respektojnë rregullat etike ose të bëhen pjesë e mekanizmave vetë-rregullues, por theksoi se "mund t'u ushtrohet presion, sidomos nga qeveritë e fuqishme dhe agjencitë shumëkombëshe (si Bashkimi Evropian), si dhe nga organet rregullatore që mund t'i detyrojnë ata t'i identifikojnë ose njohin problemet, siç janë ngacmimi kibernetik, lajmet e rreme etj., të cilat gjenden në faqet e tyre.“⁴⁹

Praktika e këshillave të etikës, të cilët janë anëtarë të AIPCE - Shoqatës së Këshillave të Pavarur të Shtypit të Evropës, në lidhje me atë se a merren me ankesat për përmbajtjet e publikuara në mediat sociale, është e ndarë. Në shumë vende, komentet në Facebook nuk janë nën kompetencat e organeve vetë-rregulluese. Ky është rasti edhe me Maqedoninë, ku ankesat mund t'u referohen vetëm përmbajtjes mediatike, ndërsa Facebook-u nuk është nën kompetencat e KEMM-it. Në disa vende, si Qipro dhe Belgjikë, këshillat e etikës shqyrtojnë ankesat ndaj komenteve në Facebook vetëm nëse një gazetar i boton ato në rrjetet sociale në mënyrë profesionale, jo në një kapacitet privat, ose publikon përmbajtje gazetareske me të cilën i shkel parimet etike.

Një shembull për ilustrim lidhur me atë se si shoqëria mund të trajtojë gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale, por edhe në përgjithësi në internet, vjen nga Sllovenia. Rasti fillon kur motra e një politikaneje në profilin e saj të Facebook-ut ka shkruar një koment i cili ka përmbajtur gjuhë

⁴⁸ Code of Deontology, Luxembourg, 2004. Gjendet në: http://ethicnet.uta.fi/luxembourg/code_of_deontology.

⁴⁹ Korrespondencë përmes e-postës me Piter Fini, Ombudsman i shtypit nga Irlanda, sekretar i Komisionit për ankesa nga mediat e Qipros, 8 gusht 2017.

urrejtjeje ndaj refugjatëve të cilët në viti 2016 transituan nëpër Ballkan drejt vendeve të Evropës perëndimore, ku është ndërlidhur me komentet e tij edhe një gazetar i radios katolike, i cili gjithashtu ka përmbajtur gjuhë edhe më agresive urrejtjeje. Pas kësaj, shoqata djathtiste e gazetarëve ia morrën çmimin gazetaresk, të cilini ia kishin dhënë atij gazetari. Megjithatë, partia e përjashtoi nga anëtarësia e saj dhe publikoi këtë informacion. Ky është vetëm një shembull se si shoqëria dhe organizatat – politike dhe gazetareske – mund të trajtojnë mënyrat e padëshiruara të sjelljes, duke përfshirë edhe sjelljen në internet.⁵⁰

Në një situatë ku rrjetet sociale mbeten një nga hapësirat e hapura, kur bëhet fjalë për abuzimin me të drejtat e njeriut dhe standardet etike dhe profesionale, këshillat etike propozojnë hapjen e një dialogu me rrjetet sociale, si Facebook dhe Twitter. Qëllimi nuk është të imponohet kontroll ose të kufizohet liria e shprehjes, por të rritet ndërgjegjësimi mbi përgjegjësinë që kanë ndaj përdoruesve të tyre në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të cilat vlejnë si në internet (online) ashtu edhe jashtë tij (offline).

7. PËRFUNDIM

Është e thjeshtë t'i përgjigjesh dilemës se a nevojiten zgjidhje të reja ligjore për t'u marrë me problemet që i hapën mediat e internetit me funksionimin e tyre në sferën mediatike në Maqedoni: ekzistojnë mjaft ligje. Në të vërtetë, megjithëse ligjet e mediave, Ligji për Media dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nuk definojnë e as përfshijnë internetin, gjë që në shikim të parë jep përshtypjen se sfera e mediave të internetit nuk është rregulluar, legjislacioni maqedonas përmban dhjetëra ligje, të cilat përmes disa dispozitave, rregullojnë aspekte të ndryshme të veprimit, krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve nga mediat e internetit.

Problemi i vërtetë është aplikimi jo i përpiktë, selektiv dhe jo parimor i ligjeve ekzistuese në praktikë, si dhe inercia dhe mosveprimi i institucioneve kompetente në procedimin dhe sanksionimin e dukurive të paligjshme në internet. Para se të flasim për zgjidhje të reja ligjore, fillimisht duhet të testohet funksionaliteti dhe efikasiteti i rregullativës që tashmë ekziston, por nuk zbatohet. Zgjidhjet e reja ligjore vetëm do të çonin në një "ri-rregullim" të sferës, siç thotë Saraçini,⁵¹ por, nuk do të garantojë zbatimin dhe procedimin për të cilin fillimisht nevojitet vullneti politik dhe institucional. Komuniteti mediatik dhe gazetaresk duhet të mbajnë një dialog të vazhdueshëm me institucionet kompetente, ose të ushtrorjnë presion ndaj tyre që të kryejnë obligimet e tyre të përcaktuara.

Nga ana tjetër, cilat janë avantazhet e vetë-rregullimit sa i përket rregullimit të mediave në internet? Në rrethana të ndryshmeve të vazhdueshme teknologjike në sistemet mediatike, ai është: më fleksibël në krahasim me rregullimin nga ana e shtetit, më efikas dhe më i shkurtër se një proces i gjatë gjyqësor dhe me kosto shumë më të ulët për qeveritë dhe shoqërinë. Përveç kësaj, anëtarësimi i mediave të internetit në organet vetërregulluese ju mundëson atyre të "dalohen" si media të besueshme, dhe si media që punojnë në mënyrë profesionale dhe ofrojnë informacione të besueshme për publikun në internet.

⁵⁰ Video nga debati: „Si të arrijmë deri te ballafaqimi i suksesshëm me gjuhën e urrejtjes“ organizuar nga IMM, 7 korrik 2017. Gjetet në: <https://www.youtube.com/watch?v=r8cqF1R0-r0>.

⁵¹ Saraçini, P., (ed.) et al., *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisë gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në: http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf.

Trupi vetërregullues KEMM, së bashku me komunitetin gazetaresk dhe mediatik në Maqedoni duhet t'i popullarizojnë këto parime në mesin e mediave të internetit dhe komunitetit të internetit. Përgjegjësia dhe detyrimet u takojnë praktikisht të dyja palëve. Nevojitet edukim i vazhdueshëm i aktorëve të industrisë së internetit, të cilët nëse duan të merren me gazetari, ata duhet t'i respektojnë në mënyrë të përpiktë rregullat etike dhe profesionale, e që janë të njëjta si për mediat e internetit (online) ashtu dhe për ato jashtë tij (offline).

Ndryshimet e shpejta teknologjike në mjedisin mediatik imponojnë nevojën që KEMM-i, në bashkëpunim me aktorë të tjerë, t'i plotësojnë me udhëzime të reja parimet e vendosura etike dhe profesionale që zbatohen në mediat tradicionale. Kjo do të ndihmojë mediat e internetit të krijojnë procedurat e tyre të brendshme dhe kodet e sjelljes, ndërsa mbetet e hapur mundësia e aderimit të tyre në KEMM.

Në të gjithë peizazhin, edhe pse e fundit në këtë analizë, megjithatë roli i edukimit mediatik të publikut është gjithashtu vendimtar. Publiku duhet të edukohet dhe udhëzohet për mënyrën se si të dallojnë lajmet cilësore në detin e mediave, cilat janë faktet, cilat janë manipulimet dhe gënjeshttrat, dhe si të bëjë krahasimin e burimeve. Në fund, publiku i edukuar në fushën e mediave është ai që do të bëjë zgjedhjen e duhur, si në mesin e mediave tradicionale, ashtu edhe në internet.

8. REKOMANDIME

1. Institucionet dhe trupat relevant duhet të zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore, të cilat janë pjesë e rreth 10 ligjeve ekzistuese, në mënyrë të përpiktë, e që kanë të bëjnë me mediat e internetit dhe komunikimin në internet, në mënyrë që të parandalohet sjellja dhe shpërndarja e paligjshme e përmbajtjeve të paligjshme në internet.
2. Komuniteti i gazetarëve dhe i mediave duhet të vazhdimisht të komunikojë me të gjitha institucionet dhe trupat kompetent me qëllim të zbatimit të shpejtë dhe efikas të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me mediat e internetit, atëherë kur ligjet shkelen.
3. Vetë-rregullimi duhet të ketë përparësi para rregullimit të mediave të internetit, sepse është më i shpejtë, më fleksibël dhe opsion me kosto më të ulët. Rregullimi mund të paraqet rrezik për pluralizmin mediatik dhe për lirinë e mediave.
4. Mediat e internetit që merren me gazetari duhet të jenë transparente sa i përket strukturës së tyre pronësore dhe impresumit, e para së gjithash t'i respektojnë parimet etike dhe profesionale, të cilat janë të njëjta pa marrë parasysh platformën në të cilën transmetohen përmbajtjet (media tradicionale apo të internetit).
5. Trupi vetërregullues KEMM, në bashkëpunim me komunitetin e gazetarëve, duhet vazhdimisht të zhvillojë dialog me komunitetin e internetit me qëllim të avancimit të Kodit ekzistues etik me udhëzime të reja për raportim profesional, të cilat do të vazhdojnë edhe për mediat e reja të internetit. Këto udhëzime mund të plotësohen dhe zhvillohen varësisht nga sfidat e reja me të cilat ballafaqohet gazetaria në internet, me çka do t'i ndihmojnë edhe vetë

mediat e internetit që të vendosin procedura të brendshme të sjelljes dhe krijimit të përmbajtjeve.

6. Trupi vetërregullues, KEMM, në bashkëpunim me komunitetin e gazetarve dhe të mediave, dhe me institucionet relevante, duhet të nxitë projekte edukative dhe novatore, të cilat do ta përfshijnë edhe komunitetin e internetit, me qëllim që të rritet profesionalizmi dhe përgjegjësia e tyre.

7. Trupi vetërregullues, KEMM, duhet të iniciojë ose të kyçet në projekte a inicitiva të tjera për përmirësimin e edukimit mediatic të publikut, i cili kur të arrijë ta kuptojë më mirë realitetin mediatic dhe përmbajtjet mediaticke, do ta ketë më të lehtë përzgjedhjen e përmbajtjeve cilësore dhe burimeve në internet.

9. BIBLIOGRAFIA

ASHAAVM, „Qëndrimi i Agjencisë lidhur me detyrimin e mbikëqyrjes së paraqitjes zgjedhore mediatike në portalet e internetit“, ASHAAVM, Shkup, 2016. Gjetet në: http://avmu.mk/images/Stav_na_Agencijata.pdf.

Bllazhevska, K., „'Po' për lirinë, 'jo' për ligjin“, Deutsche Welle, 29 prill 2013. Gjetet në: <http://b2.mk/news/da-za-slobodata-ne-za-zakonot?newsid=FCEN>.

Enti Shtetëror i Statistikës i RM-së, Statistika sipas sferave – shoqëria informatike: treguesit kyç për vitin 2016. Gjetet në: <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=27>.

„SHGM dhe EFJ kundër rregullimit ligjor të portaleve dhe përmbajtjeve mediatike“, Nova Makedonija, 26 prill 2017. Gjetet në: <http://bit.ly/2hO4Cvv>.

Instituti për Studime Komunikimi - ISK, Raport mbi monitorimin dhe mbulimin e fushatës zgjedhore në lajmet televizive, 30 nëntor-9 dhjetor 2016 (fq. 54), Projekti „MODEM“, ISK, 2016. Gjetet në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM/dek/MODEM-izvestaj-dekemvri-MK.pdf>.

Prezantim në konferencën për projektin INFOCORE, e mbajtur në Ohër, më 4 korrik 2016, në kuadër të projektit INFOCORE-Informing Conflict Prevention, Response and Resolution: The role of Media in Violent Conflict.

Saraçini, P., (ed.) et al, *Maqedonia në epokën dixhitale – ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisë gjatë komunikimit në internet*, IMM, Shkup, 2015. Gjetet në: http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf.

Oda ekonomike e Maqedonisë - AMM, „Kërkesë nga AMM“, 31 gusht 2016. Gjetet në: http://avmu.mk/images/Baranje_od_MMA.pdf.

Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC (2016)5*, Komiteti i ministrave, 13 prill 2016. Gjetet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415fa.

Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/REC (2011)7*, Komiteti i ministrave, 21 shtator 2011. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/101403?download=true>.

Tahiri, S. Dhe Adamçevski, M., *Raportimi në interes të publikut – Mbrojtja e parimeve etike të raportimit gjatë punës së Komisionit për ankesa*, KEMM, Shkup, 2017. Gjendet në: <http://www.semm.mk/attachments/izvestuvanje-vo-interes-na-javnosta.pdf>.

Hulin, A. dhe Ston, M., (ed.) *Udhëzues për vetë-rregullimin e mediave online*, OSBE, Vjenë 2013. Gjendet në: <http://www.osce.org/mk/fom/316166?download=true>.

ARTICLE 19, *2016 Annual Colloquium on fundamental rights–Public consultation on "MEDIA PLURALISM AND DEMOCRACY"*, Response of ARTICLE 19, 2016. Gjendet në: http://ec.europa.eu/information_society/newsroom/image/document/2016-44/article_19_en_18798.pdf.

Center for insights in survey research, *"Survey of Macedonian Public Opinion"*, April 19-25 2016, IRI. Gjendet në: http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/iri_macedonia_survey_april_2016_0.pdf.

Code of Deontology, Luxembourg, 2004. Gjendet në: http://ethicnet.uta.fi/luxembourg/code_of_deontology.

Diaz-Campo, J., и Segado-Boj, F., *"Journalism ethics in a digital environment: How journalistic codes of ethics have been adapted to the Internet and ICTs in countries around the world"*, *Telematics and Informatics*, 32 (4), 735-744, 2015. Gjendet në: <http://reunir.unir.net/bitstream/handle/123456789/2826/D%C3%8DAZ-CAMPO%20Y%20SEGADO%20-%20JOURNALISM%20ETHICS%20DIGITAL.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.

Jenkins, C., *"Fake online news from Macedonia: who's behind it?"*, Channel 4, 24 nëntor 2016. Gjendet në: <https://www.channel4.com/news/fake-news-in-macedonia-who-is-writing-the-stories>.

Tuneva, M. and Milenkovski, S., *Employment and Working Conditions for the Journalists in the Republic of Macedonia*, MIM, Skopje, 2015. Gjendet në: http://seemediapartnership.cji.ro/wp-content/uploads/2017/02/Macedonia_Final.pdf.

Ligje:

Kodi zgjedhor (2016), (teksti i spastruar). Gjendet në: <https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zM2lkMkZERFoONXc/view>.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë (1996). Gjendet në: <http://www.pravda.gov.mk/documents/KRIVICEN%20ZAKONIK%20precisten%20%20tekst.pdf>.

Ligji për media (2013) dhe Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (2013). Gjendet në: www.avmu.mk.

Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje (2012). Gjendet në: <http://bit.ly/2vS37SY>.

Burime të tjera:

Ueb-faqeja e internet-agregatorit të lajmeve Time.mk. Gjetet në: <http://www.time.mk/s/all>.

Video nga debati: „Si të arrijmë deri te ballafaqimi i suksesshëm me gjuhën e urrejtjes“ organizuar nga IMM, 7 korrik 2017. Gjetet në: <https://www.youtube.com/watch?v=r8cqF1R0-r0>.

Korrespondencë përmes e-postës me Petros Pterides, sekretar i Komisionit për ankesa nga mediat e Qipros, 8 gusht 2017.

Korrespondencë përmes e-postës me Piter Fini, Ombudsman i shtypit nga Irlanda, sekretar i Komisionit për ankesa nga mediat e Qipros, 8 gusht 2017.